Ndal Punës së Fëmijëve

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve nëpërmjet edukimit, artit dhe medias

Tregu i punës

Organizata Ndërkombëtare e Punës

Objektivi: Njohja me mekanizmat e tregut të punës dhe ndikimin që kanë ata në aspekte të ndryshme të punës së fëmijëve. Realizimi i takimeve ndërmjet palëve shoqërore. Nxitja e debatit ndërmjet tyre për të tërhequr vëmendjen ndaj problemit të punës së fëmijëve dhe marrjen e përgjegjësive për të ndihmuar në zhdukjen e kësaj dukurie. Nxitja e debatit ndërmjet palëve (qeverisë, punëdhënësve, sindikatave) për temën e punës së fëmijëve.

Përfundimi: Thellimi i njohjes për rolin që luajnë subjektet e ndryshme sociale për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve. Rritja e shkallës së ndëgjegjësimit të komunitetit dhe mbledhja e fondeve.

Koha

6 orë mësimi të veçanta
ose 3 orë mësimi dyshe

Shënim për përdoruesin

Realizimi i këtij moduli mbështetet në modulet “Shkrimi krijues”, “Kërkimi dhe informacioni”, “Intervista dhe sondazhe”, “Debati” dhe dy modulet për mjetet e komunikimit. Prandaj, para se të zhvilloni këtë modul, është mirë të keni zhvilluar modulet e sipërpërmendura.
Realizimi i këtij moduli është shumë i rëndësishëm, pasi i ndihmon të rinjtë të kuptojnë si funksionojnë dhe ndërveprojnë elemente të caktuara që përbëjnë shoqërinë. Gjithësesi, është mirë që të rinjtë të kenë arritur një nivel të caktuar të njohjes së problemit dhe të përvetësimit të aftësive të nevojshme për të përfituar ashtu siç duhet nga ushtrimet që propozohen në këtë modul.
Në modulin “Kërkimi dhe informacioni” të rinjtë kanë fituar disa njohuri rreth raporteve që ekzistojnë ndërmjet organizatave të ndryshme dhe qeverisë, si dhe përparësive që ato kanë. Gjatë realizimit të modulit “Intervista dhe sondazhe” ata kanë patur mundësi të vendosin lidhje me persona të njohur të tregut të punës. Moduli “Shkrimi krijues” i ka ndihmuar të shprehen në mënyrë krijuese, ndërsa modulet për mjetet e komunikimiti i kanë pajisur me disa aftësi apo shprehi komunikuese. Me modulin “Debati” kanë fituar disa shprehi për të mprehur armën e tyre retorike në mbrojtje të fëmijëve që punojnë, duke paraqitur argumente serioze para eksponentëve të tregut të punës.

Motivimi

Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) përbën një organizatë të vetme në kuadrin e sistemit të Kombeve të Bashkuara, pasi ajo përmbledh jo vetëm vendet anëtare, por dhe organizatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe të punëtorëve.

Një strukturë e tillë është përcaktuar si tripalëshe. Kjo u referohet marrëdhënieve të veçanta që vendosen ndërmjet palëve sociale në gjirin e ILO-s, ku punëtorët, punëdhënsit dhe qeveritë punojnë së bashku për të përcaktuar ligje dhe norma që duhet të zbatohen në mjediset e punës për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve në të gjithë botën.

ILO nxit bashkëpunimin tripalësh në vendet anëtare nëpërmjet promovimit të dialogut shoqëror ndërmjet punëdhënësve, punëtorëve dhe shtetit. “Dialogu shoqëror” është shprehje e tratativave që bëhen ndërmjet tri palëve që përbëjnë modelin e tripartitizmit: qeveri, punëdhënës dhe sindikatë. Bëhet fjalë për “dialog”, pasi kemi të bëjmë me shkëmbimin e mendimeve ndërmjet tri palëve që kanë interesa të caktuara, të merren vesh ndërmjet tyre dhe të kenë mirëkuptim për një situatë të caktuar, çështje apo problem ekonomik dhe shoqëror. Përcaktori shoqëror tregon se kemi të bëjmë me ndërthurje të interesave të shtresave të ndryshme shoqërore, nga njëra anë, dhe që zhvillohet në interes të shoqërisë, nga ana tjetër.

Në mënyrë analoge, ky modul përpiqet të promovojë shkëmbimin e përvojës shoqërore ndërmjet të rinjve dhe organizatave qeveritare, punëdhënësve dhe sindikatave që funksionojnë në vend. Procesi edukativ ka të bëjë pjesërisht me kuptimin e funksionimit të tregut të punës dhe të fakti që të gjithë ne kemi përgjegjësi ndaj asaj që zhvillohet në shoqëri. Gjithësesi, funksionimi i këtyre organizatave nga një vend në tjetrin është i ndryshëm dhe kjo duhet të mbahet parasysh gjatë realizimit të modulit. Ndoshta strukturat dhe sistemet që do të jepen në modul, nuk përputhen me ato të vendit tuaj, por, gjithësesi, nuk mendojmë se kjo gjë do të pengojë realizimin e veprimtarive të modulit. Ndoshta duhet të bëni disa ndryshime për t’ia përshtatur modelit tuaj tripalësh.

Procesi i ndëgjegjësimit duhet të jetë shumë i gjerë dhe të përfshijë veçanërisht ata njerëz dhe ato institucione që kanë mundësi të sjellin ndryshime të menjëhershme të situatës: qeverinë, punëtorët (sindikatat) dhe punëdhënësit. Nuk mjafton vetëm t'u japim njohuri të rinjve për realitetin e punës së fëmijëve dhe mjetet për t'i shfrytëzuar dhe për t'i përhapur këto njohuri, por është gjithashtu e rëndësishme të jepen këto njohuri në kuptime të caktuara për të nxitur rritjen e njohurive të tyre për ekonominë dhe shoqërinë. E gjithë kjo do t'i ndihmojë të rinjtë për të qartësuar dhe për të përcaktuar disa prej objektivave kyç në fushatën e tyre ndëgjegjësuese dhe do t'i mbështesin në përpjekjet e tyre për të rritur shkallën e ndërgjegjësimit dhe të ndërhyrjeve konkrete në këtë drejtim.

Nëse në vendin tuaj ekziston puna e fëmijëve, shteti dhe palët shoqërore duhet të punojnë së bashku për ta mënjanuar plotësisht këtë dukuri dhe për t'i integruar fëmijët në shoqëri, duke u siguruar shkollimin dhe duke ndihmuar familjet e tyre.

Ky modul u shpjegon të rinjve se çfarë mund të bëhet konkretisht për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve, si dhe rolet e ndryshme në planin ekonomik dhe shoqëror.

Gjithashtu, moduli i ndihmon të rinjtë të ndërtojnë raporte më të ngushta me këto institucione dhe të kuptojnë më mirë tregun e punës. Se fundi, moduli do t'i informojë këto instanca për ekzistencën e projektit dhe punën e të rinjve, si dhe do të nxisë ndihmën konkrete që ata mund të japin. Ky është një hap i ri që ata bëjnë në lidhje me rritjen personale dhe shkallën e përgjegjësisë që i promovon në rolin e forcës shoqëror që nxit ndryshimin.

Përgatitja

Para se të fillojë realizimi i këtij moduli, duhet të bëni një studim paraprak rreth tri grupeve të tripartitizmit: qeverisë, organizatave të punëdhësve dhe organizatave të punëtorëve (sindikatat) për të parë si funksionon sistemi në vendin tuaj. Informohuni nëse të tria palët zhvillojnë programe edukative për të rinjtë. P.sh., shumë sindikata zhvillojnë programe me të rinjtë për t'i njohur ata me tregun e punës dhe për t'i informuar për të drejtat e tyre, për përparësitë që kanë po të regjistrohen në sindikatë, si dhe shërbimet e ndryshme që u ofrohen të rinjve. Nëse keni mundësi, mund të ftoni nga një përfaqësues për secilin grup.

Informohuni nëse në shkollën ku zhvilloni projektin apo në komunitetin tuaj, ka përfaqësues të ndonjë enti shtetëror, të ndonjë sindikate apo të një organizate punëdhënësish, pasi mund t'ju ndihmojnë në realizimin e modulit.

Ndihma e jashtme

Nga ana tjetër, ju kujtojmë se nëse zhvilloni projektin në një shkollë, atje mund të ketë një sindikatë të mësuesve. Në këtë rast, drejtohuni një përfaqësuesi të sindikatës për ta përfshirë në projekt, si dhe për të gjetur mundësinë e përfshrijes në të edhe të një drejtuesi.

Çfarë duhet

- Letër, laps dhe penë,
- Dërrasë e zezë dhe tabak letre,
- Projektorë,
- Telefon.

Realizimi i modulit

Cilësia e realizimit të modulit do të varet nga interesi i grupit dhe nga përfshirja e përfaqësuesve të të tria palëve. Grupi duhet të përpiqet të takojë të paktën një prej përfaqësuesve të tyre ose të tre së bashku. Sigurisht, është më mirë të merret takim me të tre përfaqësuesit, pasi secili prej tyre luan një rol të caktuar në sfondin socialekonomik të shoqërisë.

Përfshini të gjithë grupin në realizimin e takimeve: nxiteni dhe ndihmojeni të telefonojë apo t'u shkruajë selive lokale të organizatave të punëdhënësve, ndërmarrjeve lokale, organizatave të punëtorëve dhe zyrave të informacionit publik. Kjo është një përvojë e mirë për të rinjtë. Çdo letër që dërgohet, duhet të ndiqet nga një telefonatë. Grupi mund të ndahet në nëngrupe të vogla dhe secilit prej tyre i caktohet të vendosë lidhje me institucione shtetërore, organizata të punëdhënësve dhe punëtorëve. Kjo mund të jetë një zgjidhje e përshtatshme për të arritur sa më shumë subjekte, pasi krijon një proces nxitës që pasurohet me diskutime interesante në gjirin e grupit.

Organizimi i grupit

Për dy veprimtaritë e para, është mirë që grupi të ndahet në tri nëngrupe, në mënyrë që secili prej tyre të punojë me një organizatë: qeveritare, punëdhënësish ose sindikate. Zgjedhja e tyre bëhet në rrugë demokratike. P.sh., me short.

Nëse grupi është shumë i madh, do të jetë mirë të ndahet në 5-6 nëngrupe, me 3-4 veta secili, pasi në këtë mënyrë mund të arrihet përfshirja dhe pjesëmarrja e të gjithëve. P.sh., nëngrupi që merret me organizmat qeveritarë, mund të ndahet në nëngrupe të tjera sipas ministrive; për punëdhënësit u këshillohet të rinjve të zgjedhin një organizatë për të zhvilluar kërkimin e tyre; për punëtorët mund të zgjedhin ndërmjet sindikatave të ndryshme. E rëndësishme është që secili pjesëmarrës i grupit të ketë një detyrë për të kryer.

Veprimtaria 1: Kërkimi

1 orë mësimi e veçantë ose 2 orë mësimi me një hapësirë në mes për të kryer kërkimin

Si fillim, të rinjtë sqarojnë se cila është saktësisht veprimtaria e secilës palë të strukturës tripalëshe. Në vende të ndryshme ka organizima të ndryshëm të ministrive, sindikatave dhe ndërmarrjeve. Para se të fillojnë punën, është e rëndësishme që të rinjtë të dinë sa të thella janë njohuritë e grupit për këto institucione, lidhjet e drejtërdrejta që ka secili me punën e fëmijëve dhe ndihmesën e mundshme që mund të japë.

Për karrierën e mëtejshme shkollore dhe profesionale të të rinjve, është e rëndësishme të dinë si të marrin informacionin e duhur, si ta bashkërendojnë dhe të analizojnë arritjet dhe, së fundi, si ta paraqesin në përshtatje me objektivin që kanë.

Shënim për përdoruesin

Për përgatitjen e kësaj veprimtarie, ju këshillojmë t'i ktheheni modulit "Kërkimi dhe informacioni", i cili do t'ju ndihmojë që së bashku me grupin të nxirrni në pah mënyrat e ndryshme të realizimit të kërkimit për një çështje të caktuar.
Ndoshta do t'ju duhet të punoni në internet apo bibliotekë. Të dyja këto burime, gjatë realizimit të një kërkimi, janë shumë efektive. Një alternativë tjetër është intervistat e bëra nga vetë të rinjtë. Ata edhe mund t'u shkruajnë apo t'u telefonojnë personave që kanë lidhje me kërkimin. Gjithësesi mbani në vëmendje se ka burime të ndryshme publike të informimit, veçanërisht organizatat e punëdhënësve në lidhje me shifrat e punësimit.

Përcaktimi i detyrave

Detyra e grupit do të jetë kërkimi apo mbledhja e informacionit për një organizatë të përzgjedhur. Ajo mund të realizohet në mënyra të ndryshme. E rëndësishme është që të gjithë të përfshihen. Disa nga pyetjet që mund të bëni, janë: "Ç'rol duhet të ketë ministri i Arsimit në fushatën kundër punës së fëmijëve?", "A ka në qytetin tuaj dyqane apo lokale që përdorin punën e fëmijëve?", "Si veprohet në këto lokale?" etj. Të rinjve do t'u kërkohet të qëmtojnë dhe të mbledhin fakte dhe të dhëna nga dokumentet që do të konsultojnë gjatë procesit të kërkimit. Pyetje të tjera, në të cilat të rinjtë duhet të ndalen, jepen më poshtë:

- Ç'janë duke bërë organizatat e ndryshme në lidhje me punën e fëmijëve?
- Cili është pozicioni i tyre në lidhje më punën e fëmijëve: e dënojnë apo e tolerojnë këtë dukuri?
- Në ç'mënyrë ndihmojnë në mbështetje të fushatës kundër punës së fëmijëve?
- A pranojnë të jenë pjesë dhe përgjegjës të fushatës globale?
- A kanë marrë ndonjë nismë dhe nëse po, cilat janë ato?
- A kanë ndonjë projekt në lidhje me punën e fëmijëve?

- A është organizata pjesë e një rrjeti rajonal apo ndërkombëtar?
- Si funksionon ky rrjet dhe çfarë bën për të luftuar punën e fëmijëve?
- Në cilat nga fushat është më e fortë apo më e dobët organizata?
- A janë të gatshme të ndihmojnë në në gjetjen e informacionit që lidhet me punën e fëmijëve?

Organizimi i kërkimit

Të rinjtë duhet të ndihmohen kur vendosin lidhje me përfaqësuesit e organizatave të ndryshme apo të ndërmarrjeve të mëdha. Gjatë kësaj faze është shumë e rëndësishme t'i qëndroni afër secilit prej grupeve, duke i ofruar ndihmë dhe mbështejte kur ju kërkohet. Nëse mund t'ju ndihmojnë persona të jashtëm, p.sh., mësues të tjerë apo prindër, ky është momenti që duhet të pranoni ndihmën e tyre. Ky ushtrim kërkon dëshirë të madhe, vullnet, shumë entuziazëm dhe energji. Shpjegoni qartë se çfarë vlere dhe ndihmese ka kjo veprimtari, krahas karakterit të saj praktik.

Për t'ju ndihmuar, po japim më poshtë organizata të ndryshme, shtetërore a sindikaliste, zyra dhe departamente që mund të vendosni lidhje për problemin e punës së fëmijëve.

Qeveria qendrore

Ministira e Punëve të Jashtme. Është institucioni kryesor i shtetit që është përgjegjës për veprimtaritë dhe marrëdhëniet me jashtë.

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale. Është dikasteri ku të rinjtë duhet të takojnë personat përgjegjës për të zbuluar se cilat janë të drejtat në vendin e punës, cilat janë format e mbrojtjes dhe mekanizmat që sigurojnë respektimin e të drejtave nga ana e punëdhënësve dhe çfarë ndodh nëse këto të drejta nuk respektohen, cila është mosha më e vogël e punës për fëmijët. Gjithashtu, në këtë dikaster, ata mund të mësojnë se çfarë mbrojtje sociale siguron shteti për personat në vështirësi; si përballet me problemin e varfërisë dhe ç'bën në rastet kur në të përfshihen edhe të rinjtë; cilat janë kriteret për të përfshirë familjet në ndihmën sociale dhe si realizohet kjo ndihmë; në ç'mënyrë ndihmon shteti për rritjen e nivelit të jetesës së popullësisë nëpërmjet afrimit të vendeve të punës, arsimit, banimit etj.; a ka rrjete të ndihmës sociale në vend etj.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Këtu të rinjtë do të mësojnë se cila është mosha e hyrjes në shkollë dhe sa vite zgjat detyrimi shkollor, do të sqarohen për lidhjen ndërmjet detyrimit shkollor dhe moshës më të vogël të punës për fëmijët, si dhe ndikimin që ka kjo e fundit në parandalimin e punës së fëmijëve. Këtë gjë të rinjtë duhet ta zbulojnë vetë. Një drejtim tjetër e kërkimit mund të përqendrohet në Konventën 138 të ILO-s për moshën më të ulët të punës për fëmijët, e cila përbën njëkohësisht konventën më kryesore në fushtën globale të luftës kundër punës së fëmijëve. Nxiteni grupin t'i përgjigjet pyetjes përse ndodh një dukuri e tillë dhe nëse te ne shkolla është falas.





Pushteti vendor

Grupi është e domosdoshme të marrë takim me përfaqësues të pushtetit vendor për të mësuar nëse janë të ndërgjegjësuar për problemin e punës së fëmijëve dhe për rrjedhojat që ka ajo për shoqërinë, si dhe për të zbuluar se ç'lloj veprimtarie duhet të ndërmarrin për të ndihmuar në fushatën për mënjanimin e plotë të kësaj dukurie. Duhet të dini që shumë nga këto nivele të pushtetit vendor lidhen drejtpërdrejt me nivelin qendror, siç është arsimi, shëndetësia, problemet e punësimit, të çështjeve sociale etj. Po t'i referohemi vendeve evropiane



që bëjnë pjesë në Bashkimin Evropian, do të shikojmë se autoritetet lokale janë pjesë e një rrjeti rajonal që, për interesa të përbashkëta, ka strukturën e vet të komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit. Në kuadër të fushatës globale për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve, është e nevojshme të sigurohet pjesëmarrja politik në të gjitha nivelet. Falë punës që do të bëjnë qindra të rinj në të gjithë botën, në kuadrin e realizimit të këtij moduli, do të përfshihen gjithmonë e më shumë komuniteti dhe politikanët e këtyre niveleve, duke rritur shkallën e tyre të ndëgjegjësimit ndaj veprimtarive të ndryshme që zhvillohen në këtë fushë.

Krahas takimeve që duhet të kenë me organizmat e mësipërëm, duhet t'i shtyni të rinjtë të takohen me politikanë të të gjithë spektrit:

- presidentin e vendit dhe këshilltarët e tij;
- kryeministrin dhe zëvendëskryeministrat;
- kryetarët e partive politike dhe zëvendësit e tyre në nivel qendror dhe lokal;
- kryetarët e bashkive, të komunave;
- personalitete politike të njohur dhe që gëzojnë respekt edhe pse nuk kanë detyra qeveritare;
- politikanë që janë veçanërisht të interesuar për çështjet sociale dhe të zhvillimit;
- politikanë të rinj;

Punëdhënësit

Organizatat e punëdhënësve kanë një rol të nënvleftësuar në fushatën botërore për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve. Fjala është për fëmijët që punojnë jo rrallë në kushte të papranueshme. Nëse ata punojnë, kjo nuk ndodh në ndërmarrjen e prindërve. Kryesisht punojnë për shoqëri dhe individë që përdorin krahun e tyre të punës. Janë pra pikërisht pundhënësit që gjenerojnë punën e fëmijëve. Por ka dhe shumë të tjerë që punojnë në ndërmarrje të vogla, siç janë ndërmarrjet bujqësore, në të cilat fëmijët punojnë për prindërit ose të afërmit e tyre. Kjo takohet shpesh tek fëmijët që punojnë në bujqësi.

Ndodh që punëdhënësit punësojnë fëmijë pa e ditur, por kjo nuk i përjashton ata nga përgjegjësia që kanë. Janë pikërisht ata përgjegjësit kryesorë të punës së fëmijëve. Punëdhënësit, në të gjithë botën, kanë përgjegjësi shoqërore për punëtorët, në kuptimin më të gjerë të fjalës.

Një shembull tipik janë ndërmarrjet ndërkombëtare. Me zgjerimin dhe integrimin e ekonomisë në nivel rajonal dhe global, një ndërmarrje mund të zhvillojë një veprimtari të shumëllojshme. Kështu, një ndërmarrje që prodhon veshje sportive, mund të gjejë lehtësisht krah punë të lirë në të gjithë botën, mund të sigurojë dhe ndërmarrje transporti me kosto të favorshme për të shpërndarë prodhimin e vet. Nga ana tjetër, këto ndërmarrje ndërkombëtare mund të kryejnë veprimtarië kontabël në një vend dhe operacionet e tjera, si marketingun, në një vend tjetër. Në të vërtetë, ndodh që selitë e ndërmarrjeve ndërkombëtare mund të jenë në disa zyra të vogla në një vend prej ku drejtojnë gjithë veprimtarinë në shkallë botërore. Pikërisht këtu e ka zanafillën çështja delikate e përgjegjësisë. Nëse prodhuesi në vendin A ka licencë për të qepur veshje sportive, i prodhon këto veshje në një ndërmarrje ndërkombëtare të një vendi B, duke përdorur krahun e lirë të punës së fëmijëve të atij vendi, i trasporton duke përdorur një ndërmarrje transporti të një vendi C, e cila për të paketuar veshjet, përdor përsëri punën e fëmijëve. Në këto kushte është shumë e vështirë të gjendet përgjegjësi kryesor për punën e fëmijëve. Është punëdhënësi i vendin A apo ndërmarrja e vëndit B? Është

përgjegjës pronari i dyqanit që shet veshjet sportive në vendin X, vend që deklarohet krejt i paditur për faktin e përdorimit të punës së fëmijëve apo...? Është fajtor vendi A që ka nxjerrë ligjet për të mënjanuar plotësisht punën e fëmijëve, apo janë fajtorë vendet B dhe C që nuk kanë mbikqyrur respektimin e normave themelore për punën dhe të drejtat e njeriut. apo janë fajtorë konsumatorët që i blejnë dhe nuk verifikojnë se kush i ka prodhuar?

Ndoshta, në përgjithësi, është fajtore vetë shoqëria që nuk ka penguar zhvillimin e punës së fëmijëve.

Në analizë të fundit, të gjithë jemi fajtorë. Të gjitha subjektet institucionale dhe e gjithë shoqëria janë përgjegjës dhe kanë një rol për të luajtur dhe, aq më tepër, punëdhënësit që kanë një rol shumë të madh për të mënjanuar përdorimin e punës së fëmijëve në ndërmarrjet e tyre. Në analizën në grup, këto duhet të jenë çështjet dhe problemet që do të diskutoni.

Punëdhënësit, përveç atyre që kanë ndërmarrje shumë të vogla, bëjnë pjesë në shoqata. Në përgjithësi, këto shoqata përshtasin kodin e sjelljeve dhe të praktikave të mira që kanë të bëjnë me disiplinën e punës, përfshirë edhe punën e fëmijëve. Në përgjithësi, këto shoqata bëjnë pjesë në organizata më të mëdhaja që veprojnë në nivel rajonal apo ndërkombëtar. Në këtë mënyrë, edhe një dyqan i vogël në një qytet të vogël duhet të jetë pjesë e një rrjeti më të gjerë. Në këtë kuadër, gjatë procesit të kërkimit duhet t'i nxisni të rinjtë të regjistrojnë të gjithë punëdhënësit. Një person shumë i rëndësishëm mund të jetë dyqanxhiu që keni fare pranë, në lagjen tuaj. Krahas takimit që duhet të keni me këta persona, për të njohur praktikën që përdorin për marrjen në punë, duhet të shtrini investigimin tuaj edhe në shoqatën që ata janë, pasi vetëm kështu procesi juaj kërkimor do të jetë më i plotë.

Punëdhënësit nuk janë përgjegjësit e vetëm të punës së fëmijëve, edhe pse duhet të mbajnë përgjegjësi të plotë për kushtet e këqija të punës në të cilat, jo rrallë, i detyrojnë të punojnë fëmijët. Disa nga këto organizata të punëdhënësve kanë bashkëpunim me qeverinë, me sindikatat dhe me organizata të ndryshme të Kombeve

të Bashkuara, që janë kompetente për të mënjanuar plotësisht burimin e punës së fëmijëve. Që fushata botërore për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve të jetë e suksesshme, duhet që të bashkohen të gjithë përfaqësuesit e të tria grupeve dhe të ndërthurin veprimtarinë e tyre për t'i ndryshuar gjërat.

Sindikatat dhe organizatat e punëtorëve

Në përgjithësi, sindikatat janë të vëmendshme ndaj problemeve që lidhen me zhvillimin e shoqërisë dhe të drejtat e njeriut. Fillimisht ato u krijuan për të mbrojtur të drejtat e punëtorëve. Më vonë e kuptuan se përballë fuqisë ekonomike të punëdhënësve dhe fuqisë politike të qeverive, vetëm bashkimi i fuqive mund t'u lejonte të arrinin përmirësimin e kushteve të jetës dhe të punës. Në vendet e zhvilluara, para shekullit XX, puna e fëmijëve ishte shumë e përhapur. Falë luftës së sindikatave dhe zhvillimit social, gjendja ndryshoi, u ribënë ligjet, arsimi u përmirësua dhe fëmijët arritën të kenë mbrojtjen e duhur.

Qëllimi kryesor i sindikatave është mbrojtja e interesave të punëtorëve, garantimi i kushteve të përshtatshme të punës, sigurimi i pagave të pranueshme dhe respektimi i të drejtave nga ana e punëdhënësve për këdo. Me kalimin e kohës, me zhvillimin social-ekonomik të vendeve, edhe roli dhe funksionet e sindikatave kanë ndryshuar. Ato sot përfshihen në veprimtari të shumëllojshme, që përfaqësojnë të gjitha çështjet shoqërore dhe të zhvillimit. Në këtë mënyrë, roli i tyre si organizata shoqërore është forcuar së tepërmi dhe në këtë mënyrë mund të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në fushatën botërore për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve.

Lëvizja sindikaliste është pjesë e një rrjeti më të gjerë organizatash në nivel ndërkombëtar. Solidariteti ndërkombëtar i këtyre organizatave mund të ketë një ndikim shumë të fortë në këtë fushatë. Në veprimtarinë e tyre kërkuese, të rinjtë mund të ndalen në njohjen e këtyre organizatave dhe të filialeve të tyre, të shpërndara në të gjithë botën. Disa organizata sindikaliste, rajonale

Shënim për përdoruesin

Meqë ka një histori të pasur të krijimit dhe konsolidimit të lëvizjes sindikaliste, si dhe një reformë ndërkombëtare të tregtisë dhe të ligjeve, nëse projekti zhvillohet në shkollë, do të ishte e udhës të kërkonit ndihmën e një mësuesi tjetër për ta bërë sa më konkret procesin e kërkimit. Kështu, p.sh., mësuesit e historisë, të ekonomisë etj., mund të ndihmojnë në nivelin e informacionit bazë që u duhet fëmijëve në procesin e kërkimit. Gjithashtu, dihet se shumë sindikata kanë zhvilluar programe edukative të shumta që u kushtohen të rinjve. Mundohuni ta shfrytëzoni këtë mundësi për të rritur shkallën e pjesëmarrjes në këtë proces.

dhe ndërkombëtare janë bashkuar me programin për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve. Ato ndërmarrin nisma dhe zhvillojnë programe edukative për këtë çështje në shumë vënde të botës. Njohja e tyre i ndihmon të rinjtë të kuptojnë rëndësinë, natyrën e rolin që kanë sindikatat.

Sindikatat janë organizata që luftojnë në rreshtin e parë për problemet e punës. Anëtarët e tyre punojnë në vende ku mund të ekzistojë dhe të shfrytëzohet puna e fëmijëve. Madje, ka raste që ata punojnë krah për krah me fëmijët. Për këtë, është shumë e rëndësishme të rritet puna ndëgjegjësuese dhe edukative me ta. Sindikatat dhe anëtarët e tyre mund të luajnë një rol shumë të rëndësishëm, pasi mund të monitorojnë gjendjen e punës së fëmijëve në raport me punëdhënësit dhe autoritetet kompetente.

Në kuadër "të dialogut social", sindikatat mund të punojnë me qeveritë dhe organizatat e punëdhënësve për të përpunuar strategji për parandalimin e punës së fëmijëve. Në fakt dukuria vazhdon: vend të të rriturve, punësohen fëmijë. Dhe lind pyetja përse ndodh kjo. Duke punuar së bashku: qeveria, sindikatat dhe punëdhënësit, puna e fëmijëve mund të parandalohet. Dihet se atje ku sindikatat janë të forta, puna e fëmijëve nuk arrin të përhapet. Pra, është e qartë që një ndër objektivat e rëndësishëm për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve, është krijimi i sindikatave të forta dhe mbështetja e veprimtarisë së tyre.

"Përse vazhdon ende të ekzistojë puna e fëmijëve edhe në vendet ku ka ligje dhe sindikata?",- kjo është një pyetje e njohur. Kemi mbërritur kështu në disa prej problemeve kryesore të shoqërisë, si janë: të varfërisë, të dallimeve kulturore, të traditës, të mungesës së arsimit, të mungesës së infrastrukturës arsimore, të borxheve të jashtme etj. Puna e fëmijëve nuk do të mënjanohet plotësisht vetëm pse ekzistojnë sindikatat. Sigurisht, sindikatat mund të japin ndihmesë të rëndësishme për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve, por, njëkohësisht, të gjitha subjektet duhet të bashkohen dhe të punojnë për t'i ndryshuar gjërat.

Paraqitja e përfundimeve

Jepini mundësi grupit të paraqesë përfundimet duke përdorur disa metoda efektive. Më pak efektive janë diskutimet e gjata, të cilat aty-këtu shoqërohen me disa të dhëna statistikore dhe batuta, të cilat e vështirësojnë të kuptuarit e problemit. Këmbëngulni që të gjithë pjesëtarët e grupit të paraqesin diçka. Paraqitjet nuk duhet të jenë të gjata. Metoda më e mirë është ajo që arrin të tërheqë dhe të mbajë gjallë interesin e publikut, madje e shtyn atë të marrë pjesë me ndërhyrje dhe këshilla të përshtatshme. Po rendisim disa prej këtyre formave që janë me fryt:

- përdorimin e videoprojektorit – stimulimi viziv;
- përdorimin e lojës me role – shndërrimi i paraqitjes në një shfaqje ku njëri është intervistuesi dhe tjetri i intervistuari ose në një emision televiziv, në një debat parlamentar etj. (për të elektrizuar publikun, ka gjetje nga më të ndryshmet);
- përdorimi i metodave ndërvepruese– nxitet publiku të shprehë mendimet e veta, të cilat komentohen nga një ekspert në sallë.

Duke trajtur çështjen e paraqitjes dhe të dhënies së informacionit, shpjegojini grupit rëndësinë që ka përdorimi i duhur i gjesteve dhe i shprehjes së fytyrës. Nëse e keni të vështirë për këtë seancë, kërkoni ndihmën e një personi të jashtëm. P.sh., nëse projekti zhvillohet në kushtet e shkollës, mund të lindë një diskutim për një temë të caktuar, të cilën mund ta drejtojë shumë mirë mësuesi i asaj fushe. Edhe ndonjë prej prindërve që ka përvojë në këtë drejtim, mund të luajë rolin e moderatorit të seancës. Për ta gjallëruar edhe më shumë atmosferën e paraqitjeve, propozoni shpërndarjen e dy çmimeve:

- një çmim për paraqitjen me përmbajtje më të thellë;
- një çmim për paraqitjen me karakter krijues.

Secili grup duhet të përgatisë një raport me të dhënat e mbledhura. Raportet do të shërbejnë si për mbledhjen e informacionit, ashtu dhe për të mbajtur gjallë kujtesën kolektive të projektit. Gjithashtu, ato shërbejnë edhe për intervistat e ushtrimit 2.

Veprimtaria 2: Intervista

2 orë mësimi

Secili grup duhet të zgjedhë një përfaqësues nga institucionet apo organizatat e sipërpërmenduara: qeveria, punëdhënësit dhe sindikatat. Ashtu si në modulin "Intervista dhe sondazhe", këto kategori duhet të përfshihen sa më shumë të jetë e mundshme, si, p.sh., duke ftuar politikanë, biznesmenë, drejtues të sindikatave dhe të OJF-ve, t'u flitet për projektin dhe të merren reagimet e tyre në formën e debatit publik a të dramatizimit. Intervistat mund të realizohen gjatë zhvillimit të këtyre vizitave.

Shënim për përdoruesin

Për realizimin e kësaj detyre, ju këshillojmë t'i referoheni modulit "Intervista dhe sondazhe", pasi do t'ju ndihmojë në organizimin dhe realizimin e intervistave në lidhje me zhvillimin e brainstormingut, zgjedhjen e kandidatëve, realizimin e kontakteve, përdorimin e videoregjistruesit, realizimin e intervistës etj., që janë elemente shumë të rëndësishme për këtë ushtrim.

Ndoshta grupi ka patur përvoja të mëparshme për realizimin e intervistave. Në raste të tilla, mund të kapërcehet kjo fazë dhe të kalohet në atë të fundit, të ushtrimit. Por mund të vendosni të bëni intervista, këtë radhë me përfaqësues të tjetër.

Modulet "Informacioni bazë" dhe "Intervista dhe sondazhe" e ndihmojnë grupin për të formuluar pyetjet që do t'u bëhen të intervistuarve.

Veprimtaria 3
Debati tripalësh për punën e fëmijëve

1 orë mësimi më vete dhe 2 orë mësimi së bashku
1 orë mësimi shtesë për ushtrimin fakultativ

Shënim për përdoruesin

Është e këshillueshme që moduli i debatit të jetë bërë para se të filloni modulin e tregut të punës. Në këtë ushtrim debati duhet të ketë formën e një debati parlamentar apo debati formal. Për këtë ushtrim nuk është e këshillueshme të përdorni "debatin lëvizës". Grupi do të luajë rolin e të tria palëve.

Në këtë moment grupi është njohur me rolet dhe funksionet e të tria palëve dhe mund të vërë në provë dhe të përdorë në mënyrë të përshtatshme njohuritë e veta.

Ndajeni grupin në tri nëngrupe, një për çdo subjekt të përfshirë: qeverinë, punëdhënësit dhe punëtorët. Objektivi i veprimtarisë është që fëmijët, sipas këndvështrimit të subjektit që përfaqësojnë, të trajtojnë problemin e punës së bashkëmoshatarëve të tyre. Ata duhet të diskutojnë rreth punës së fëmijëve. Ky është një ushtrim shumë i mirë për të integruar të tria palet në projektin tuaj dhe të ndihmoni të rinjtë të kuptojnë problemin e punës së fëmijëve dhe të të drejtave të tyre nga këndvështrime të ndryshme. Duke e parë problemin nga këndvështrime të ndryshme, do t'i ndihmoni të kuptojnë sa e rëndësishme është që të gjitha palet të bëjnë detyrën e vet për të zgjidhur problemin.

Siç ndodh dendur, debati duhet të ketë: një temë, një çështje, një rezolutë dhe një mocion, të cilat përcaktojnë natyrën dhe parametrat e tij. Në ushtrimet e mëparshme të modulit të debatit, grupi do të ketë pranuar apo do të ketë kundërshtuar mocionin. Në këtë ushtrim nuk duhet të jemi në favor apo kundër një mocioni, por duhet të analizohet strategjia politike dhe kuptimi i të tria palëve të përfshira, duke paraqitur argumente të ndryshme për t'i mbështetur, që të arrijnë në një marrëveshje të pranueshme dhe të kënaqshme për të tria palët, pra në një vendim.

Në këtë ushtrim do të ketë vetëm një argument për të diskutuar:

Mbrojtja e fëmijëve nga shfrytëzimi.

Nxjerrja në pah e këshillave për diskutimin

Secili nëngrup duhet të tërhiqet për të gjykuar rreth çështjes. Bëni kujdes që pyetjet të mos rreshtohen sipas rëndësisë apo pëlqimit që keni. Lista është e gjatë dhe e ndarë në shumë seksione, prandaj do të ishte më mirë t'i parapërgatisnit, t'i shumfishonit dhe t'ua u ndanit nëngrupeve. Më pas citoni problemin që do të diskutoni, dhe lexoni listën e pyetjeve duke u siguruar që të gjithë ta kenë kuptuar qëllimin e ushtrimit.

Qëllimi është që secili nënëgrup t'i diskutojë problemet që dalin, nga këndvështrimi i palës që përfaqëson. Secila prej tyre, qeveria, punëdhënësi dhe punëtorët, do të ketë mendime dhe qëndrime të ndryshme, në varësi të rolit dhe të përgjegjësive që ka.

Përcaktimi i fëmijës

- Cili është konceptimi i secilës palë për përcaktimin e fëmijës në lidhje me moshën, ç'kritere të tjera duhet të merren parasysh për përcaktimin e fëmijës;
- Cili është përcaktimi i punës së fëmijës për secilën palë.

Arsimi

- A duhet të jetë i detyrueshëm arsimi;
- Në rast se po, cila duhet të jetë mosha e detyrimit shkollor;
- Çfarë parametrash duhet të pranohen për të rregulluar punën e fëmijëve që nuk kanë arritur moshën e detyrimit shkollor;



Mosha më e vogël e punës

- Në ç'moshë mund të lejohet puna e fëmijëve, a duhet të ketë një kufi të moshës më të vogël për punë për fëmijët;
- A duhet të jetë e njëjtë mosha minimale e punës për të gjitha llojet e punës apo duhet të ndryshojë në varësi të natyrës së punës, p.sh., duhet të ketë një moshë më të madhe në rastet e punëve të vështira dhe të rrezikshme, si: puna në miniera, në ushtri, punët e natës etj.

Përcaktimi i punës

- Si duhet të përcaktohet koncepti i punës kur ka të bëjë me fëmijët, p.sh., nëse fëmijët venë në shkollë, a duhet të lejohen të shkojnë në punë, qoftë edhe me kohë të pjesshme, në ç'mënyrë kategorizohen punët në të lehta, të mesme dhe të rënda;
- Çfarë trajtimi duhet të ketë për fëmijët që bëjnë punë shtëpie apo punojnë në ndërmarrjen bujqësore të familjes, a duhet t'u lejohet fëmijëve të punojnë në këto kushte edhe pse shkojnë në shkollë, a duhet të përcaktohen kufij që të mbrohen fëmijët në këto kushte;
- Nëse pranojmë që fëmijët mund të bëjnë punë të lehta, cili është përcaktimi i llojit të punës dhe cilat janë kufijtë, p.sh., a duhet të pranohet që punësimi i fëmijëve në këto lloje punësh ndikon në arsimimin dhe shëndetin e tyre fizik dhe mendor etj.

Kushtet e punës

- Cili duhet të jetë orari i punës së fëmijëve në lloje të ndryshme të punëve, po për ata që punojnë me kohë të pjesshme, po për fëmijët që kanë braktisur shkollën dhe punojnë me kohë të plotë, po për llojet e punëve që mund të jenë të dëmshme dhe të rrezikshme për shëndetin;
- A duhet të caktohet një pagë minimale për fëmijët, po për ata që shkojnë në shkollë dhe punojnë me kohë të pjesshme, a është e drejtë të përcaktohen

nivele të ndryshme page për fëmijët e moshave të ndryshme, si duhet të përcaktohen këto nivele;

- A është e nevojshme të përcaktohen kushtet e punës, kushtet sanitare dhe të sigurisë për mjediset ku punojnë fëmijët si me kohë të pjesshme, ashtu dhe kohë të plotë etj.

Punë të rrezikshme- format më të këqija të shfrytëzimit

- Ku duhet mbështetur për përcaktimin e punës së rrezikshme;
- Në rastin e shfrytëzimit seksual të fëmijëve apo të situatave në të cilat fëmijët janë të detyruar të zhvillojnë veprimtari jo të ligjshme, si, p.sh., shpërndarje droge apo forma të tjera të kriminalitetit, cili duhet të jetë qëndrimi i të tria palëve, si duhet të trajtohen këta fëmijë dhe familjet e tyre, po për ata fëmijë që shfrytëzohen seksualisht;
- Cila duhet të jetë pozita e të tria palëve në rastin e trafikimit të fëmijëve, në ç'mënyrë mund të kontrollohet dhe të parandalohet kjo veprimtari, ç'ndodh kur janë të përfshira dhe familjet etj.

Monitorimi

- Në rastet e mundshme të shfrytëzimit të fëmijëve dhe të dhunimit të të drejtave të tyre, si mund ta kontrollojnë situatën të tria palët;
- A duhet të veprojnë së bashku apo njëra prej tyre, në veçanti, duhet të ketë të gjithë përgjegjësinë, ç'duhet bërë, ç'sisteme dhe procedura duhet të ndiqen;
- Cilat duhet të jenë sanksionet për ndërmarrje, organizata apo dhe individë të veçantë që shkelin ligjin duke marrë në punë fëmijë, a duhet të ketë një sistem ndëshkimor;
- Në ç'mënyrë duhet të veprojnë të tria palët që ta bëjnë punën e fëmijëve një problem të madh të shoqërisë që të gjithë të kuptojnë se është e gabuar dhe që duhet të përpiqen për ta shmangur atë;

A duhet të zhduket tërësisht në çdo shoqëri puna e fëmijëve, a ka sektorë ku mund të tolerohet puna e fëmijëve, kush duhet t'i vendosë dhe t'i kontrollojë këto etj.

Gjatë parashtrimit të të gjitha grupeve të problemeve, është e natyrshme që diskutimi i tyre do të nxjerrë edhe të tjera. Kjo gjë duhet të nxitet. Qëllimi ynë nuk është të japin një listë me probleme dhe të gjallërojmë kreativitetin e të rinjve, por të veçojmë e të nxjerrim në dukje idetë që ata janë në gjendje të përpunojnë.

Bashkëngjitur këtij moduli do të gjeni një listë me pyetje të grupuara sipas titujve: grupi i qeverisë, grupi i punëdhënësve dhe grupi i puntorëve, që do t'i ndihmojnë të rinjtë të kuptojnë shqetësimet dhe interesat e të tria palëve, si dhe të zbatojnë udhëzimet e duhura. Do të jetë mirë që të zhvillohet një debat me secilin grup në lidhje me pyetjet përkatëse. Ndiqeni diskutimin që të siguroheni që e secila palë e ka kuptuar se cili duhet të jetë roli i tyre kundrejt problemeve që ngrihen.

Siguroni kohën e mjaftueshme për përgatitjen dhe diskutimin. Qëllimi i ushtrimit është që të rinjtë të përpunojnë një listë me udhëzime për mbrojtjen e fëmijëve ndaj shfrytëzimit ekonomik, si dhe të bëjnë një deklaratë paraprake që përcakton pozicionet e tyre. Udhëzimet dhe deklarata duhet të përfaqësojnë pikëpamjen e palës që ata përfaqësojnë. Gjatë kryerjes së ushtrimit, secili grup do të ketë nevojë për ndihmën tuaj. Prandaj, gjatë gjithë kohës, duhet të kaloni nga një grup tek tjetri, t'u jepni këshilla, t'i mbështesni dhe t'i nxisni. Sigurohuni që të gjithë të marrin pjesë në diskutim. Secili grup duhet të caktojë një ose më shumë zëdhënës, të cilët do të mbajnë shënim këshillat që dalin. Një pjesëtar tjetër i grupit duhet të lexojë deklaratën paraprake të grupit dhe duhet të caktohet një tjetër zëdhënës që do të jetë përfaqësuesi i grupit në takimin përfundimtar tripalësh. Zëdhënësit mund të konsultohen në vazhdimësi me pjesëtarët e grupit, madje çështje të caktuara mund të mbrohen nga pjesëtarë të tjerë të grupit.



Ndihma e jashtme

Në këtë moment do të ishte e dobishme të siguroni një ndihmë të jashtme. P.sh., nëse projekti zhvillohet në shkollë, mund të kërkoni ndihmën e mësuesve të ekonomisë, të shkencave shoqërore, gjeografisë etj., për të ndihmuar grupin për t'u përgatitur për debatin. Ndihma e tyre është e vlefshme në drejtim të thellimit të njohurive sipas fushave përkatëse, si dhe i ndihmon anëtarët e grupit të përsosin e të pasurojnë detajet e debatit.

Ky ushtrim është një mundësi e mirë për të ftuar përfaqësues të qeverisë, të punëdhënësve dhe sindikatave të marrin pjesë në punën e grupit që t'i ndihmojnë në paraqitjen e argumenteve në debat. Ndihmesa e tyre është edhe më e dobishme për komunitetin e përfshirë në projekt.

Debati tripalësh

Për organizimin e debatit, mbështetuni në modulin e debatit, veçanërisht në seksionet e quajtura: "Zhvillimi i modulit" dhe "Organizimi i grupit". Meqë ky ushtrim do të ketë formën e një debati formal, pjesëmarrësit nuk duhet të shprehen prerë në favor të njërit apo tjetrit mendim. Edhe në këtë moment është mirë të përfshihet një ndihmë e jashtme.

Për zhvillimin e ushtrimit është mirë që një zëdhënës i grupit të lexojë deklaratën e bërë nga grupi në lidhej me mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik. Deklaratat nuk duhet të jenë të gjata dhe të detajuara, por të përqendrohen dhe të nxjerrin në pah më mirë pozicionin e tyre në lidhje me problemin.

Pas leximit të deklaratave, diskutimi dhe debati do të zhvillohen në lidhje me udhëzimet e paraqitura nga grupet për problemin. Meqë është e nevojshme një pikënisje, ajo mund të jetë përcaktimi i fëmijës, problemi i arsimit të detyruar ose mosha më e vogël e punës dhe rreziqet që sjell. Në të gjitha rastet, secili grup duhet të shpallë pozicionin e vet, strategjinë politike, opinionet e veta, sigurisht edhe rekomandimet.

Gjatë vazhdimit të debatit për çështje të ndryshme, nxisni shkëmbimin e mendimeve ndërmjet grupeve. Nëse nuk keni një ndihmës të jashtëm, debati të drejtohet nga ju. Mund të ndodhë që trajtimi i një argumenti të ngjallë diskutime të forta pranuese ose jo. Në të dyja rastet bëni kujdes që këto opinione të shprehen në mënyrë

të ekuilibruar. Mos lejoni që debati të kthehet një një garë ulërimash kush bërtet më shumë, por, njëkohësisht, nxitini të gjithë të shprehin mendimet dhe të bëjnë komentet që dëshirojnë. E tillë duhet të jetë klima e një debati tripalësh. Të rinjtë duhet të kuptojnë se në këto debate çdokush duhet të shprehë mendimet dhe idetë nga pozita e palës që përfaqëson. P.sh., në disa raste, punëdhënësit parapëlqejnë fëmijë në një moshë më të vogël për punë, ndërsa sindikatat nuk janë dakord, pasi dëshirojnë të mbrojnë si vendet e punës të anëtarëve të tyre, ashtu dhe mirëqenien e të rinjve.

Në përfundim, mbylleni debatin dhe kërkojini grupit të votojë për çështjen mbi bazën e argumenteve të sjella. Ruani paansinë dhe veçanërisht për grupin theksoni faktin që të gjithë janë të barabartë dhe të gjithë duhet të votojnë ashtu siç u thotë arsyeja dhe ndërgjegjja. Nëse një grup është i mendimit se 16 vjeç është mosha më e mirë për punë, grupi i dytë thotë 15 vjeç dhe i treti 14 vjeç, hidhini këto mendime në votim. Shumica do të vendosë për mocionin që do të ndërmerret dhe që do të kthehet në vendim.Gjithashtu, shpjegojuni që persona të veçantë nuk janë të detyruar të votojnë mocionin e grupit të vet. Nëse grupit tjetër me argumentimin që ka bërë, i ka bindur, ata mund të votojnë një propozim tjetër. Për zhvillimin e këtij ushtrimi nuk është e nevojshme juria.

Gjithashtu, sigurohuni që një person i caktur nga grupi apo vetë ju, të marrë shënim përfundimin e votimi dhe vendimet. Diskutimet duhet të zgjasin derisa të rinjtë kanë energji dhe entusiazëm. Nëse vëreni që të dyja këto kanë rënë, është koha që diskutimet të mbyllen. Por nëse jeni të mendimit se nuk është trajtuar në thellësi, mund ta shtyni për një seancë tjetë.

Koha sa duhet të zgjasë ky ushtrim, vendoset nga ju. Nuk ka rëndësi që grupi nuk arrin në një përfundim apo në një marrëveshje dhe diskutimi bllokohet. Ajo që ka rëndësi është që grupi të arrijë të kuptojnë natyrën e botës së punës dhe mënyrën si ekonomia dhe shoqëria përpiqen

të ndërhyjnë për të kuptuar të gjitha qëndrimet dhe interesat. Të rinjtë do të kuptojnë se zgjidhja e çështjeve të ndryshme që nisin nga pozicione të ndryshme interesi, nuk është e lehtë. Edhe në këtë ushtrim ndërhyrja e mësuesve të tjerë apo e personave të jashtëm do të gjallërojë diskutimi dhe do ta pasyrojë atë me mendime dhe pozicione të reja.

Nxitini këta persona të qëndrojnë gjatë gjithë kohës së diskutimit ndërmjet tri palëve, pasi të rinjtë kanë nevojë të dëgjojnë mendime dhe vlerësime të reja. Kjo temë është e vështirë dhe mund të ndodhë që të rinjtë të ndiehen të papërgatitur për ta përballuar, por mund të ndodhë që i gjithë ushtrimi të zhvillohet në një atmosferë të këndëshme dhe argëtuese. Ju kujtojmë se duhet të nxitet grupit të jetë sa më shumë krijues dhe të gjejë informacionin e duhur. Ju duhet ta ndihmoni, por jo t'i ofroni informacion të gatshëm. Nxitini pjesëmarrësit të shprehin mendimet e tyre rreth asaj që duan të arrijnë të tria palët: qeveria, punëdhënësit dhe sindikatat dhe arsyet pse. Qëllimi nuk është të gjenden përgjigjet dhe zgjidhjet më të mira, qëllimi është t'i fusni të rinjtë në shpirtin e debatit në mënyrë që ata të argëtohen dhe të kuptojnë thelbin e konsensusit. Sa më krijues dhe me fantazi të jenë të rinjtë, aq më argëtues dhe i kënaqshëm do të jetë ushtrimi.

Në përfundim të debatit, raporti rreth tij mund të bëhet duke përdorur kolazhin, vizatime, piktura dhe shkrime. Nëse projekti zhvillohet brenda një shkolle, këtë prodhim përfundimtar mund ta varni në një kënd të shkollës që të lexohet dhe të shikohet nga të gjithë. Gjithashtu, jehonë këtij ushtrimi mund t'i bëhet duke shkruar një artikull për gazetën e shkollës.

Përballja me realitetin

Edhe pse realizimi i këtij ushtrimi kushtëzohet nga koha që keni në dispozicion, si dhe nga informacioni i nevojshëm, ju këshillojmë që ta zhvilloni pasi përmirëson në mënyrë të dukshme procesin e përvetësimit të koncepteve me të cilat të rinjtë janë njohur. Qëllimi i këtij ushtrimi është të përballen rezultatet e dala nga diskutimi tripalësh në grup me rezultate e këtyre debateve në vendin e tyre. Ndoshta një pjesë e këtij ushtrimi është zhvilluar gjatë realizimit të modulit "Kërkimi dhe informacioni". Edhe më mirë, pasi në këtë mënyrë të rinjtë kanë grumbulluar më parë sasinë e nevojshme të informacionit që duhet të kenë.

Por mund të ndodhë që të rinjtë nuk kanë informacionin e duhur. Në këtë rast është mirë të ftohet në grup përfaqësuesi i ndonjërës prej palëve që t'u japë infomacionin e duhur dhe të diskutojë me ta zgjidhjet e mundshme.

Qëllimi është që ta ballafaqohet kuptimi ligjor i vendit me rezultatet e diskutimit dhe vendimet që janë marrë prej tyre në lidhje me problemin e punës së fëmijëve. Informacionet për moshën më të vogël të punës e për arsimin e detyruar janë të publikuara në fletoret e zyrtare, në Ligjin për arsimin parauniversitar, në aktet e ndryshme nënligjore të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, pranë zyrave të punës, drejtorive arsimore rajonale dhe zyrave të arsimit. Edhe organizatat e ndryshme të punëdhënësve dhe sindikatave mund t'ju japin një informacion të tillë.

Gjithashtu, do të ishte interesante të ballafaqonit rezultatet e debatit tripalësh me normat ndërkombëtare dhe përmbajtjen e konventave të KB-së dhe të ILO-s, si dhe me rezultatet e punës në modulin "Kërkimi dhe informacioni".

Në këtë proces diskutimi të përgjithshëm në grup dhe të ballafaqimit me dispozitat normative kombëtare dhe ndërkombëtare, të rinjtë duhet të analizojnë dallimet ndërmjet tyre. P.sh., a mendon grupi se pozicioni që ka mbajtur, është më i mirë, pasi mbron më shumë fëmijët; a mendon ai se ligjet dhe dispozitat normative kombëtare dhe ndërkombëtare nuk janë efektive për të siguruar këtë mbrojtje; a kanë mendime të tjera pjeëtarët e tij për këto dallime; a dëshirojnë të thonë diçka në lidhje me këtë konstatim; a dëshirojnë të takohen më të tria palët dhe të bëjën publike komentet e tyre; a dëshirojnë t'u shkruajnë njerëzve të fuqishëm për t'u kërkuar pse nuk bëjnë më shumë për të mbrojtur fëmijët që punojnë dhe që shfrytëzohen etj.

Ky ushtrim mund të jetë shumë i vlefshëm për rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit, të emancipimit dhe përgjegjësimit të të rinjve. Tashmë që kanë informacionin e duhur dhe dinë si funksionojnë gjërat në shoqëri, e kanë të qartë si duhet të veprojnë. Ky është një hap i rëndësishëm përpara në zhvillimin vetjak të secilit dhe ju duhet t'i ndihmoni dhe t'i mbështesni veprimtaritë e tjera që ata duan të realizojnë. P.sh., mund të dëshirojnë t'u shkruajnë politikanëve lokalë apo kombëtarë, organizatave të ndryshme të punëdhënësve dhe përfaqësuesve të sindikatave, mund të dëshirojnë të bëjnë një fushatë në mjetet e komunikimit masiv apo të ftojnë përfaqësuesit e tyre në një tryezë të rrumbullakët për të diskutuar këto tema (shiko modulin "Debati"). Nëse kanë dëshirë të ndërmarrin nisma të tilla, mbështetini dhe nxitini, pasi është pikërisht kjo gjë që synon të arrijë zhvillimi i këtij moduli.

Ç'duhet bërë dhe ç'duhet të mënjanoni

- Siguroni pjesëmarrjen e të rinjve në të gjitha sesionet e këtij moduli. Është një modul interesant nga shumë pikëpamje, ndërmjet të tjerave, sepse u jep pjesëmarrësve një informacion të rëndësishëm për botën e punës, një botë kjo ku do të harxhojnë pjesën më ta madhe të jetës së tyre.
- Gjatë punës në grupe, përpiquni të krijoni një klimë të qetë, argëtuese, veçanërisht kur kërkohet shumë impenjim nga të rinjtë.
- Nxitini të rinjtë që të marrin me radhë përsipër rolin e relatorit dhe të mbajnë shënime. Kjo është një përvojë shumë e mirë, që do të jetë e dobishme për ta në prosecin e mëtejshëm të edukimit.
- Merrni në shënim propozimet e bëra nga grupi dhe nga individë të ndryshëm.

- Përdorini me fryt diskutimet përmbyllëse dhe nxitini të rinjtë të shprehen lirshëm.
- Nëse keni mundësi, përdorni një videokamera ose kompjuter, veçanërisht gjatë intervistave apo debateve.
- Nuk është e detyrueshme të realizoni të gjitha ushtrimet e modulit. Ju do të vendosni të realizonoi ushtrimet në varësi të kohës dhe burimeve të informacionit. Ndoshta do t'ju duhet të bëni vetëm një ushtrim. Atëherë zgjidhni atë që ju mendoni së është më i përshtatshmi për kërkesat e grupit dhe rrethanat.
- Përpiquni që realizimi i intervistave të bëhet pas një diskutimi të detajuar dhe një parapërgatitje serioze (shiko modulin "Intervista dhe sondazhe").
- Nxitini të rinjtë të shkruajnë letra falenderimi për ata që kanë marrë pjesë në realizimin e ushtrimeve.
- Mos i vini të rinjtë në situatë të vështirë, veçanërisht në rastet kur duhet të bëjnë intervistat apo kur duhet të luajnë rolin e zëdhënësit. Secili pjesëtar i grupit duhet të përcaktojë mirë rolin e vet. Ju takon juve të krijoni këtë atmosferë, duke u siguruar që gjithkush është ne rolin që i përket.
- Bëni kujdes që të gjithë pjesëtarët e grupit të marrin pjesë në veprimtarinë kërkimore dhe në shkrimin e letrave, pasi kjo gjë i ndihmon të zhvillojnë aftësitë komunikuese dhe të shoqërimit.
- Mos fusni veprimtari gare në këtë modul.
- Përpiquni që të lexoni shkurtimisht përmbledhjet e të gjitha punimeve të secilit grup, jo vetëm ato që ju i quani më të rëndësishmet a më të mirat. Punimet të vlerësohen me dinjitetin e njëjtë dhe ju duhet të mos shprehni gjykimin e tyre.
- Bëni kujdes që të rinjtë të mos tallen me përmbajtjen e punimeve që do të paraqiten.
- Pas ushtrimit të debatit, nëse grupi dëshiron të vazhdojë me veprimtari të tjera, mbështeteni fuqimisht. Mbështetja dhe nxitja juaj janë të një rëndësie të madhe. Ato u rrisin të rinjve besimin në vetvete dhe në aftësitë e grupit.

Diskutimi përfundimtar

Një orë mësimi

Në përfundim të ushtrimit të fundit, mblidheni grupin në klasë dhe siguroni një atmosferë të këndshme e çlodhëse. Në këtë seancë përfundimtare, në se është e mundshme, ftoni edhe përfaqësues të jashtëm. Varini nëpër mure materialet e prodhuara gjatë zhvillimit të ushtrimeve, raporte të intrevistave, regjistrime në video apo rezultatet e debatit të të tria palëve.



Bisedoni për rrugën që ka ndjekur grupi, dhe nxisni bisedën për të gjitha aspektet e punës, duke filluar që me fazën përgatitore deri në realizimin përfundimtar të veprimtarisë. Kërkojini grupit të shprehet se çfarë e ka kënaqur dhe çfarë e ka zhgënjyer më shumë. Nxitini të rinjtë të shprehen hapur dhe lirshëm për gjithçka. Fakti që ndiehen mirë e shprehen lirshëm, u jep besim dhe çimenton lidhjen ndërmjet tyre.

Diskutimi përfundimtar i këtij moduli nuk do të jetë i lehtë, falë punës së realizuar nga të rinjtë. Tregu i punës është një sistem njohurish dhe informacioni shumë i rëndësishëm për të rritur shkallën e ndërgjegjësimit të tyre për punën e fëmijëve. I ndihmon ata të konkretizojnë problemin, të kuptojnë më mirë pse-të e kësaj problematike dhe si t'i mbrojnë më mirë fëmijët. Nëpërmjet debatit të të tria palëve do të kuptojnë më mirë se në ç'mënyrë ata janë pjesë dhe zgjidhje e problemit.

Gjithashtu, për të realizuar këtë diskutim përmbyllës, konsultohuni me diskutimet përfundimtare të moduleve "Intervista dhe sondazhe" dhe "Kërkimi dhe informacioni", që përmbjanë informacionin e duhur për të zhvilluar atë.

Vlerësimi dhe vazhdimi

Përsa u përket treguesve të vlerësimit, ky modul të afron mundësi specifike që janë arritur ose jo. Në varësi të ushtrimeve që keni bërë, grupi realizon një veprimtari kërkimore, intervista, si dhe debatin për punën e fëmijëve ndërmjet të tria palëve.

Tregues të tjerë të këtij moduli janë më pak të dukshëm. Në të vërtetë, procesi individual i rritjes së secilit pjesëmarrës do të vërehet në modulet e mëpasme, në të cilat ju, si edukator, do të keni mundësi ta identifikoni.

Në fakt, ky modul u jep të rinjve një mundësi komunikimi me qeverinë, organizatat e punëdhënësve dhe sindikatat, elemente këto shumë të rëndësishme, veçanërisht për të ardhmen, kur këta ata do të bëhen të rritur dhe do të fillojnë të mendojnë për të ardhmen e tyre akademike apo profesionale. Në planin e zhvillimit vetjak dhe të aftësive shoqërore, ky modul është i një rëndësie të veçantë. Një moment tjetër që përforcon ndjenjën e përgjegjësisë tek të rinjtë është fakti që në këto ushtrime ata vihen në rolin e aktorëve të tjerë dhe përpiqen të mendojnë dhe të veprojnë nga këndvështrimi i tyre në lidhje me problemin. Kjo i ndihmon të kuptojnë se çfarë mund të bëjnë qeveritë, organizatat e punëdhënësve dhe sindikatat në kuadër të fushtës ndërkombëtare për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve.

Pasi të keni përfunduar këtë modul, mund të zhvilloni modulin “Mjetet e komunikimit” apo, nëse e keni zhvilluar, mund të kaloni në modulin “Loja me role” ose “Dramatizimi”.

Shtesa 1

Çështje për diskutim në debatin e të tria grupeve që përfaqësojnë tri palë shoqërore

Grupi i qeverisë

Interesat kryesorë të këtij grupi janë:

- *Ligjet.* Ka ligje për të cilat vendi ka nevojë për të mbrojtur popullsinë për të menazhuar dhe për të mbrojtur punën, fëmijën dhe të garantojnë zhvillimin shoqëror të vendit në një vështrim të përgjithshëm.
- *Shërbimet publike.* Çfarë shërbimesh u ofron qeveria qytetarëve: shëndeti, arsimi, transporti etj.; në ç'mënyrë paguhen; a kanë të gjithë të drejtë për t'u arsimuar; a është falas arsimi apo qytetarët duhet të paguajnë diçka; a është falas apo jo sistemi shëndetësor; a është në gjendje qeveria t'i ofrojë shërbime cilësore popullsisë etj.
- *Asistenca sociale.* Në ç'mënyrë qeveria mbron ata që kanë më shumë nevojë; në ç'mënyrë përballet me problemin e varfërisë; a ka mundësi të zhvillojë një sistem asistence; cilat janë kriteret që të sigurosh asistencën shoqërore; a interesohet qeveria për rritjen demografike dhe në ç'mënyrë etj.
- *Planifikimi.* A ka qytete të mëdha në vend; a kontrollohet në mënyrë të përshtatshme zhvillimi i tyre; a ka një planifikim të zhvillimit urban; a transferohet nëpër qytete popullsia rurale dhe pse ndodh kjo; a mund të bëhet diçka për të ulur ritmet e këtij procesi; a është e zonja qeveria të investojë në zonat rurale për të ulur ritmet e këtij procesi; ç'lidhje ekziston ndërmjet planifikimit, transportit dhe shërbimeve publike; a ka një numër të mjaftueshme shkollash dhe mësuesish në zonën rurale etj.
- *Tipi i qeverisë*. A ka një qeveri qendrore që qeveris, menaxhon dhe kontrollon gjithçka; a është në gjendje qeveria të vlerësojë se është demokratike, e dobishme dhe e drejtë të decentralizojë pushtetin e saj dhe t'i lejojë pushtetit lokal të jetë përgjegjës për problemet që janë nën juridiksionin e tij; në një rast të tillë, pushteti qendror kontrollon pushtetin lokal ose ky i fundit administrohet nga politikanë të zgjedhur në mënyrë demokratike, të cilët udhëheqin veprimtaritë e ndryshme të qarkut, p.sh., a kanë të drejtë të vendosin ata si duhet të jetë arsimi apo puna në rajonin e tyre etj.
- *Të drejtat shoqërore*. Liria dhe të drejtat e njeriut: a përpiqet qeveria të sigurojë mbështejten e popullit duke i garantuar mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave

të njeriut përfshirë edhe të drejtat e fëmijëve; a kanë punëtorët të drejta sindikaliste; në ç'nivel është demokracia; cili është çmimi që duhet të paguajnë etj.

Grupi i punëdhënësve

Interesat kryesorë të këtij grupi janë:

- *Ligjet.* Çfarë ligji do të dëshironin punëdhënësit për të disiplinuar, p.sh., moshën më të vogël të punës; a do të dëshironin të kufizonin të drejtën e punëtorëve për t'u organizaur në sindikata për të kërkuar paga dhe kushte më të mira pune; si do të reagonin ndaj një sistemi më efektiv të inspektimit të punës; a do të ishin në favor të ligjeve më efektive që mbrojnë punën e fëmijëve etj.
- *Përgjegjësia shoqërore.* A duhet punëdhënësit të investojnë një pjesë të fitimeve të tyre për të financuar shkollat, për të promovuar zhvillimin shoqëror dhe të kolektivitetit, për të përmirësuar infrastrukturën, punësimin, për të përmirësuar sistemin e tërheqjes së plehërave, për mbrojtjen e mjedisit etj.; a duhet që edhe ata të përgjigjen për çfarë ndodh në shoqëri etj.
- *Privatizimi dhe shërbimet publike.* A janë sipërmarrësit për shërbime publike të cilësisë së mirë që paguhen nga mbledhja e ndihmave dhe që adminsitrohen nga administrata publike apo dëshirojnë që edhe këtë fushë ta vlerësojnë si fitimprurëse dhe ta administrojnë me një kosto të ulët në dëm të cilësisë; a do të parapëlqenin të privatizoheshin këto shërbime dhe t'i ofroheshin blerësit më të mirë; si do të realizohej funksionimi i tyre, p.sh., a mendojnë se sistemi i arsimit duhet të privatizohet apo duhet të mbetet shtetëror etj.
- *Sigurimet shoqërore.* Pagesat per pensionet, sëmundjet, lejet e lindjes për gratë, shkolla e fëmijëve të punëtorëve etj., kushtojnë shumë. Të ndihmosh për sistemin shëndetësor që shteti u siguron shtetasve, gjithashtu, është e kushtueshme. Si mendojnë punëdhënësit, a duhet të paguajnë për sistemin e pensioneve apo duhet vetë punëtorët të paguajnë për to; parapëlqejnë ata që pensionet t'i derdhin në shoqëri private apo në shtet; mendojnë se duhet t'i ndihmojnë punëtorët në nevojë, të ndihmojnë për shkollimin e fëmijëve të tyre që të rrisin kushtet e tyre të jetesës apo janë të mendimit t'u japin kredi që duhet t'i paguajnë me interes për të arritur këto gjëra; në ç'masë duhet të jenë përgjegjës punëdhënësit për koston e shoqërisë; a janë ata të interesuar për fatin e punëtorëve, të shoqërisë dhe të mjedisit të vendit të tyre etj.
- *Të drejtat e punëtorëve dhe punëdhënësve.* A dëmtohen punëdhënësit nëse punëtorët regjistrohen në sindikata të fuqishme që u dëgjohet zëri në qeveri dhe në opinionin publik; çfarë mendojnë për të drejtat dhe liritë e njeriut, a duhet të jenë ato për të gjithë apo në disa raste duhet që këto të drejta dhe liri të jenë të kufizuara; kush vendos; a duhet të kenë të drejta të plota punëdhënësit dhe pse; po qeveria a është e drejtë që t'u imponojë ligje dhe rregulla punëdhësve, madje duke u kufizuar disa nga të drejtat që ata dëshirojnë t'i kenë etj.

- *Organizimi.* A janë të bashkuar punëdhënësit në mbrojtjen e interesave të tyre; a mendojnë se mund të përplasen në mënyrë autonome me punëtorët dhe qeverinë apo do të jetë më mirë të krijojnë një federatë, duke bërë kështu një mbrojtje më të fuqishme të interesave të tyre etj.

Grupi i punëtorëve

Interesat kryesorë të këtij grupi janë:

- *Përgjegjësitë e sindikatave*. Cili është roli i sindikatave; ç' përfaqësojnë; kush i përdor shërbimet e tyre, vetëm anëtarët që paguajnë kuotën apo dhe familjarët e tyre; a merren edhe me çështje që janë jashtë sferës së punës, me sferën e të dobtëve dhe të margjinalizuarve; a luajnë një rol në shoqëri për të garantuar dhe për të mbrojtur zhvillimin normal; në ç'mënyrë financohen; kush i paguan shpenzimet dhe rrogat e tyre; ç'rrjedhojë ka kjo për pavarësinë e tyre; a janë anëtarët e sindikatave që kërkojnë atë që duhet të bëjnë apo në të kundërtën; a kanë financime nga punëdhënësit apo qeveria, pse dhe në ç'mënyrë; a do të thotë kjo që qeveria dhe punëdhënësit luajnë rolin e tyre në atë që bëjnë dhe thonë sindikatat etj.
- *Ligjet***.** Sindikatat interesohen për të patur ligje që mbrojnë anëtarët e vet dhe familjet e tyre, të dobtit e shoqërisë, mjedisin dhe që garantojnë demokraci dhe të drejtat themelore të njeriut. Janë vigjilentë dhe kontrollojnë moslejimin që njëra prej palëve të bëhet shumë e fuqishme duke vendosur ligje që kënaqin dëshirat dhe interesat e veta. Po kështu, ato mendojnë nëse është e nevojshme që të përcaktohet mosha më e vogël për punësim, cila duhet të jetë kjo moshë; a duhet të lejohet që të rinjtë të punojnë natën me orare të gjata, me pagë të ulët, në kushte të vështira për shëndetin dhe jetën e tyre dhe cilat janë punët që vënë në rrezik shëndetin e tyre mendor dhe karakterin; në ç'mënyrë i mbron sindikata këta të rinj; si duhet të përfshihet në këto probleme; a ka një lidhje ndërmjet moshës më të vogël të punës dhe detyrimit shkollor, në ç'mënyrë i zgjidh qeveria këto dy nevoja; çfarë dënimesh duhet të ketë për punëdhënësit që shfrytëzojnë punën e fëmijëve; në ç'mënyrë qeveria dhe sindikatat mund të kontrollojnë këtë dukuri; cilët janë faktorët e tjerë që luajnë rol në lidhje me problemin e punës së fëmijëve etj.
- *Përgjegjësia shoqërore.* Shoqëria në një mënyrë apo në tjetrën duhet të zhvillohet. A është e drejtë t'u kërkosh dy grupeve më të fuqishme shoqërore, qeverisë dhe punëdhënësve të ndihmojnë për zhvillimin shoqëror të vendit; nëse hapja e një fabrike në një qytet është shumë fitimprurëse për ndërmarrjen, a duhet t'i kërkohet kësaj të fundit, të ndihmojë për zhvillimin e qytetit dhe banorëve të saj, p.sh., duke ndërtuar një shkollë, duke mbrojtur mejdisin apo duke ndikuar në përmirësimin e tij; a është e qartë se dikush duhet të përgjigjet për të mbrojtur njerëzit, veçanërisht më të dobtit, gratë, fëmijët, të moshuarit,

të sëmurët, të varfërit; po sindikatat a duhet të kenë një përgjegjësi shoqërore se, në fund të fundit, qëllimi i tyre është të përmirësojnë kushtet e punës së anëtarëve të saj, por nuk kanë kohë dhe aftësi të merren me çështje të tjera; nëse nuk është detyra e tyre, kush duhet ta bëjë, qevria, punëdhënësit etj.

- *Varësia politike dhe financiare*. A duhet sindikatat të jenë tërësisht të pavaruara nga politika; a duhet të pranojnë ndërhyrjet e qeverisë a të punëdhënësve në veprimtarinë e tyre; a duhet të pranojnë financime nga shteti, politika apo punëdhënsit; drejtuesit e sindikatave duhet të zgjidhen nga të gjithë anëtarët apo të caktohen nga një grup i vogël personash; në ç'mënyrë sindikata mund të garantojë autonominë dhe të pengojë korrupsionin etj.
- *Shërbimet publike*. Sa e rëndësishme është për një sindikatë që qeveria të sigurojë shërbime publike cilësore; a i organizojnë sindikatat punonjësit e shërbimit publik në nivel qendror dhe lokal; kush përfiton nga shërbimet cilësore publike; në ç'mënyrë mund të ndikojnë sindikatat mbi qeverinë; a e mbështesin sindikatat procesin e privatizimit; a mbështetet në argumente të fuqishme liberalizimi i shërbimeve publike, po a vlejnë këto argumente edhe për cilësinë e tyre; kush i financon dhe kush i merr vendimet për shpërndarjen e tyre në të gjithë territorin e vendit etj.
- *Sigurimet shoqërore*. A është e drejtë që sindikatat të dinë dhe të pyesin se kush financon pensionet, arsimin, shëndetësinë, mbështetjen e të papunëve, pagesën për sëmundje, lejen e lindjes etj., duhet ta bëjë qeveria, punëdhënësit, të dy së bashku apo duhet të ndihmojnë edhe qytetarët, punëtorët, anëtarët e sindikatave; kush i menaxhon sigurimet shoqërore; a është përgjegjësi e qeverisë apo duhet të menaxhohet nga një administratë që zgjidhet në formë demokratike; cili vendos në rast mosmarrëveshjesh, gjyqi a ndonjë institucion tjetër; po gjyqet dhe gjyqtarët kush i kontrollon etj. Po kështu shtrohem edhe çështje të tilla: për të luftuar korrupsionin dhe abuzimet, sistemi gjyqësor a duhet të jetë i pavarur nga qeveria; në ç'mënyrë qeveria i bën ballë varfërisë; kush merret me ata që kanë nevoja më shumë: të sëmurët, të moshuarit, të paaftët; kush vendos t'i kategorizojë ata që kanë nevojë për ndihmë ekonomike; a duhet sindikatat të ndiehen përgjegjëse vetëm për çështjet që lidhen me anëtarët e vet etj.
- *Planifikimi i ekonomisë dhe tregtisë.* Le të supozojmë se qeveria u premton punëdhënësve që nëse ndërtojnë një fabrikë në një zonë të varfër, ata mund të paguajnë paga të ulta për punëtorët, pa u shqetësuar nga sindikatat. Le të supozojmë se qeveria bën një vesh shurdh dhe një sy qorr për punën e fëmijëve. Çfarë duhet të bëjë sindikata? Si mund të garantohet që çështjet ekonomike dhe të zhvillimit të zonave të varfra të mos përdoren si instrumente që i detyrojnë punëtorët e varfër të punojnë për një pagesë të ulët me kushte pune të papërshtatshme? Si e realizojnë mbrojtjen e fëmijëve në raste të tilla? Ligjet kombëtare duhet të funksionojnë edhe për ndërmarrje të huaja që operojnë në vend? Kush intersohet për kushtet e punës në këto ndërmarrje? A mund të organizohen sindikatat për të mbrojtur edhe interesat e puntorëve

të këtyre ndërmarrjeve? A duhet të përfshihen sindikatat në prosecin e planifikimit të ekonomisë dhe tregtisë? A janë këto çështje që u takojnë? A janë në gjendje t'u bëjnë ballë? Duhet të vendosen nga qeveria dhe sipërmarrësit apo duhet të përfshihen edhe palë të tjera shoqërore? Pse?

- *Të drejtat e punëtorëve dhe të drejtat e njeriut*. Kjo është një çështje e një rëndësie shumë të madhe për sindikatat, pasi ekzistenca e tyre qëndron në themel të veprimtarive të tyre. Nëse ekzistojnë të drejtat të tilla, kjo është falë sindikatave. Në fakt është në interes të sindikatave që çdo njeri, për më tepër një fëmijë, të gëzojë të drejtat themelore të sanksionuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Sindikatat dëshirojnë, gjithashtu, që anëtarët e vet të kenë të drejta të plota të sindikalizimit dhe të mbrohen në mënyrë të përshtatshme. Po në ç'masë mund të merret sindikata me të drejtat e të tjerëve? A nuk duhet të jetë qeveria ajo që merret me mbrojtjen e të drejtave të njeriut? Nëse nuk e bën ashtu siç duhet, kush do t'i mbrojë të drejtat e atyre që nuk i mbrojnë dot vetë, si, p.sh., fëmijët? Kush kontrollon qeverinë dhe pundhënësit për të verifikuar sjelljen e tyre? Cilët janë mekanizmat që mund të garantojnë respektimin e këtyre të drejtave?

Shtesa 2

Veprimtaria e Federatës së Sindikatave të Arsimit të Shqipërisë (FSASH) për punën e fëmijëve

Në kuadrin e Programit Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve, Federata e Sindikatave të Arsimit të Shqipërise, FSASH, në bashkëpunim me zyrën e IPEC-ut në Tiranë, kanë organizuar seminare për rritjen e kapacitetit të sindikatave shqiptare në luftën kundër punës së fëmijëve në Shqipëri nëpërmjet arsimimit.

Në Seminare janë analizuar hollësisht shkaqet e punës së fëmijëve (varfëria si faktori kryesor, mungesa e arsimit etj.), faktorët e ofertës dhe të kërkesës, pasojat e punës së fëmijëve për vetë fëmijët dhe për shoqërinë, mosha minimale e punësimit në kushtet e Shqipërisë, punët e rrezikshme, sipas konventave përkatëse dhe Vendimit të qeverisë shqiptare, detyrimet dhe masat parandaluese etj.

Një vend të rëndësishëm në këto seminare kanë zënë diskutimet për rolin e sindikatave, në përgjithësi, dhe atyre të arsimit, në vecanti, në lidhje me parandalimin e largimit të nxënësve nga shkolla dhe shmangien e punës së fëmijëve.

Në këto seminare është bërë një punë e kualifikuar dhe efektive për pajisjen e pjesëmarrësve me njohuritë më të domosdoshme për kuptimin dhe angazhimin e drejtuesve dhe sindikalistëve në luftën kundër punës së fëmijëve. Pjesëmarrësit në seminare janë pajisur me një sërë materialesh, si Konventat 138 dhe 182 të ILO-s, që lidhen drejtpërdrejt me këto çështje, lista e formave më të këqija të punës së fëmijëve, sipas Vendimit përkatës të qeverisë shqiptare, materiale të tjera informuese, sidomos për Konventën e OKB për të drejtat e fëmijëve, postera për ndëgjegjësimin e opinionit në luftën kundër punës së fëmijëve etj.

Pjesëmarësit në seminare kanë dalë në disa përfundime që përbëjnë edhe drejtime kryesore të të punës së sindikatave të arsimit që janë:

- Të shikohet mundësia e ngritjes së një njësie për problemet e punës së fëmijëve pranë Konfederatës së Sindikatave, në një mjedis, me pajisje dhe dokumentacion të mjaftueshëm.
- Shoqërimi i kësaj njësie me ngritjen e strukturave lokale të kësaj natyre, duke synuar që kjo gjë të realizohet, si fillim, në 6 prefektura, duke u shrirë më vonë edhe në 6 të tjerat.
- Ndëgjegjësim i opinionit shoqëror për këtë problem, nëpërmjet seminareve, botimeve, emisioneve në TV etj.

- Sigurimi i një bashkëpunimi efektiv të organeve përkatëse shtetërore, shkollave, komunitetit, OJQ-ve etj., dhe mbështetja e fuqishme financiare për angazhimin me këto probleme.

- Permirësimi i ndihmës sociale për familjet që janë nën nivelin e minimumit jetik dhe përmirësimi i tërë sistemit arsimor, sidomos për nxënësit me probleme dhe ata që largohen nga shkolla.

Rezolutë e Kongresit të Tretë të FSASH

Për zgjerimin e angazhimit të strukturave të FSASH-së për parandalimin e punës së fëmijëve

Kongresi i Tretë i FSASH-së, i mbledhur në Tiranë më 5 dhe 6 nëntor 2004, mbasi diskutoi në lidhje me përfshirjen dhe rritjen e rolit të FSASH-së në luftën kundër punës së fëmijëve, miraton këtë Rezolute:

1. Kongresi vlerëson punën e deritanishme në lidhje me përfshirjen dhe angazhimin e strukturave të FSASH-së për mbrojtjen e fëmijëve dhe parandalimin e punës së tyre.

2. Kongresi ngarkon këshillin drejtues dhe kryesinë e FSASH-së që të zgjerojnë angazhimin e tyre, sidomos ne drejtim të trajnimit të drejtuesve sindikalistë në nivel qendror e lokal, me qellim që ata vetë të njohin standardet ndërkombëtare në lidhje me punën e fëmijëve dhe të punojnë për të zgjeruar rrjetin e mësuesve që mund të merren me këtë çështje.

3. Një ndër drejtimet e rëndësishme të kryesise së FSASH-së në qendër, të seksioneve sindikale në rrethe dhe të këshillave sindikale në shkolla të jetë puna me nxënësit që kanë braktisur shkollën ose që rrezikojnë ta braktisin atë, si kontigjenti më i mundshëm i punës së fëmijëve dhe trafikimit të tyre. Për këtë, të ndërmerren veprime konkrete në shkallë vendi e sidomos në 4-5 rrethet me numrin më të lartë të braktisjes së shkollës (Tiranë, Shkodër, Fier, Vlorë, Elbasan, Durrës, Korçë), me synim që brenda një periudhe dyvjecare të ulet numri i nxënësve që braktisin shkollën në këto rrethe me jo më pak se 25 për qind dhe në nivel kombëtar me jo me pak se 10 për qind.

4. Kryesia e Federatës të forcojë bashkëpunimin me ILO-IPEC në Tiranë, me qëllim që strukturat e FSASH-së në qendër e në nivel lokal të përfshihen në veprimtaritë e organizuara në kuadrin e projekteve për luftën kundër punës së fëmijëve, ose të zbatojnë vetë projekte në këte fushë, duke ndërmarrë veprime konkrete me synim uljen e numrit të nxënësve që braktisin shkollën dhe të fëmijëve që punojnë.

5. FSASH të zbatojë projekte në bashkëpunim me Internacionalen e Arsimit, EI, dhe me organizatat sindikale simotra, me synim angazhimin në veprimtari

konkrete për parandalimin e braktisjes së shkollës nga nxënësit me probleme dhe rritjen e numrit të mësuesve të angazhuar në luftën kundër punës së fëmijëve.

6. Të zgjerohet me tej bashkëpunimi me organizatat jofitimprurese, OJF, shqiptare që janë të angazhuara në këtë fushë dhe të punohet për një bashkëpunim të mëtejshëm me komunitetin, administratat e shkollave, organet e pushtetit vendor dhe vetë nxënësit e fëmijët për të krijuar një front të përbashkët kundër punës së fëmijëve.

7. FSASH të zgjerojë bashkëpunimin me Sindikatën e Pavarur të Arsimit Shqiptar, SPASH, dhe të bëhet nxitëse për përfshirjen edhe të sindikatave të degëve të tjera në luftën kundër punës së fëmijëve, duke organizuar veprimtari të veçanta ose duke i përfshirë drejtuesit e këtyre sindikatave në veprimtaritë e organizuara prej saj.

8. Të sigurohet një bashkëpunim më i mirë me qendrën e trajnimit dhe studimeve sindikale për organizimin e seminareve dhe trajtimin e temave të mbrojtjes së fëmijëve dhe eliminimit të punës së tyre me drejtuesit sindikalistë të arsimit dhe të degëve e profesioneve të tjera, si edhe për ndërmarrjen e studimeve e vëzhgimeve në lidhje me punën e fëmijëve, shkaqet, drejtimet e punës për reduktimin e saj, përmirësimet ligjore etj., përfundimet e të cilave të shërbejnë si bazë për veprime konkrete të strukturave sindikale në qendër e në nivel lokal.

9. Seksionet sindikale në rrethe dhe këshillat sindikale në bazë të ndërmarrin veprime konkrete për evidentimin e gjëndjes së nxënësve që braktisin shkollën dhe të fëmijëve që punojnë, me qellim që, në bashkëpunim me administratat e shkollave dhe komunitetin, të angazhohen për uljen e numrit të tyre.

10. Të ndikohet në Këshillin Kombëtar të Punës, që të analizohet problemi i punës së fëmijëve dhe të merren vendime në lidhje me anagzhimin e strukturave qeveritare qendrore e lokale për reduktimin e saj, sidomos nëpërmjet forcimit të inspektoriatit të punës dhe ndihmës për familjet me probleme, që, për shkak të mbijetesës, i largojnë fëmijët nga shkolla dhe i detyrojnë të punojnë.

11. Gjatë negocimeve që do të bëhen me Ministrinë e Arsimit e të Shkencës dhe Ministrinë e Pushtetit Vendor për kontratën e re kolektive të punës, të përfshihen edhe problemet që lidhen me parandalimin e punës së fëmijëve, sipas pikave që përfshihen edhe në këtë rezolutë.

KSSH dhe BSPSH për luftën kundër punës së fëmijëve

Përfundime të konferencës së ICFTU për rritjen e angazhimit të KSSH dhe BSPSH për eliminimin e punës së fëmijëve

Konferenca, e zhvilluar në tetor 2004, përcaktoi disa nga veprimet që duhen ndërmarrë nga dy qendrat sindikale kombëtare, KSSH dhe BSPSH për luftën kundër punës së fëmjëve:

- Të bëhen vëzhgime për punën e fëmijëve në sektorë të ndryshëm, të cilat të kryhen ose të mbikqyren nga ana e federatave sindikale, sipas degëve të ekonomisë.
- Veçanërisht sindikatat e arsimit, të ndërmarrin veprime konkrete në ngritjen e ndërgjegjësimit të mësuesve për rëndësinë e të qënit aktivë në luftën kundër punës së fëmijëve.
- Organizimi dhe mbështetja e përfshirjes së punës së fëmijëve në kontratatat kolektive, veçanërisht në sektorin privat.
- Organizimi i trajnimeve profesionale për fëmijët që kanë braktisur shkollën ose që janë në vështirësi e në rrezik.
- Të ngrihet çështja e punës së fëmijëve në mënyrë aktive në organet tripalëshe. Autoritetet qeveritare dhe punëdhënësit kanë një rol kyç në luftën kundër punës së fëmijëve. Ne duhet të bëjmë më shumë presion ndaj tyre për të vepruar në përputhje me rëndësinë e fëmijëve për të ardhmen e vendit.
- Bashkëpunimi me inspektorët e punës për të denoncuar punëdhënësit që punësojnë fëmijë, si edhe me autoritete e partnerë të tjerë për të identifikuar fëmijët që punojnë.
- Krijimi i një komiteti monitorimi për punën e fëmijëve, i cili mund të bashkërendonte ose të ndërmerrte vëzhgime për punën e fëmijëve në nivel kombëtar dhe do të shpërndante materiale propagandistike kundër punës së fëmijëve.
- Të bëhet presion për ta pasur punën e fëmijëve në axhendën e qeverisë, duke e bashkërenduar atë me përpjekjet e përbashkëta për eliminimin e punës informale.
- Përfshira e çështjes së punës së fëmijëve në memorandumin e mirëkuptimit (i cili tani për tani është një draft), ndërmjet sindikatave, qeverise dhe përfaqësuesve të biznesit.
- Të bëhet presion mbi punëdhënësit evropianë e ndërkombëtarë, si edhe të bashkëpunohet më mirë me sindikatat ndërkombëtare dhe me qendrat sindikale kombëtare.

Rezolutë e Kongresit të Tretë të KSSH-së

**Për zgjerimin e angazhimit të strukturave të KSSH
për eliminimin e punës së fëmijëve**

1. Kongresi vlerëson punën e deritanishme në lidhje me përfshirjen dhe angazhimin e strukturave të KSSH-së për mbrojtjen e fëmijëve dhe parandalimin e punës së tyre, dhe ngarkon këshillin drejtues dhe kryesinë e saj që të zgjerojnë angazhimin e tyre, sidomos në drejtim të trajnimit të drejtuesve sindikalistë në nivel qendror e lokal, me qëllim që ata vetë të njohin standardet ndërkombëtare në lidhje me punën e fëmijëve dhe të punojnë për të zgjeruar rrjetin e drejtuesve sindikalistë qe mund të merren me këtë çështje.

2. Kryesia dhe komiteti ekzekutiv i KSSH-së të forcojnë bashkëpunimin me ILO-IPEC në Tiranë, me qellim që strukturat e saj dhe të federatave në përbërje të saj, në qendër e në nivel lokal, të përfshihen në veprimtaritë e organizuara në kuadrin e projekteve për luftën kundër punës së fëmijëve ose e zbatojnë vetë projekte në këtë fushë, duke ndërmarrë veprime konkrete me synim uljen e numrit të fëmijëve që punojnë.

3. KSSH të zbatojë projekte në bashkëpunim me ITUC dhe me organizatat sindikale simotra, me synim ngritjen dhe funksionimin e strukturave të posaçme dhe angazhimin në veprimtari konkrete për parandalimin e punës së fëmijëve,

4. Të zgjerohet më tej bashkëpunimi me organizatat jofitimprurese, OJF, shqiptare që janë të angazhuara në këtë fushë dhe të punohet për një bashkëpunim të mëtejshëm me komunitetin, organet e pushtetit vendor dhe vetë nxënësit e fëmijët për të krijuar një front të përbashkët kundër punës së fëmijëve.

5. Të sigurohet një bashkëpunim më i mirë me qendrën e trajnimit dhe Studimeve sindikale për organizimin e seminareve dhe trajtimin e temave të mbrojtjes së fëmijëve dhe eliminimit të punës së tyre me drejtuesit sindikalistë, si edhe për ndërmarrjen e studimeve e vëzhgimeve në lidhje me punën e fëmijëve, shkaqet, drejtimet e punës për reduktimin e saj, përmirësimet ligjore etj., përfundimet e të cilave të shërbejnë si bazë për veprime konkrete të strukturave sindikale në qendër e në nivel lokal.

6. Të ndikohet në Këshillin Kombëtar të Punës, me synim që të analizohet problemi i punës së fëmijëve dhe të merren vendime në lidhje me angazhimin e strukturave qeveritare qendrore e lokale për reduktimin e saj, sidomos nëpërmjet forcimit të inspektoriatit të punës dhe ndihmës për familjet me probleme, që, për shkak të mbijetesës, i largojnë fëmijët nga shkolla dhe i detyrojnë të punojnë.

7. Gjatë negocimeve që do të bëhen nga federatat në përbërje të KSSH-së për kontratat e reja kolektive të punës, të përfshihen edhe problemet që lidhen me parandalimin e punës së fëmijëve, sipas pikave që përfshihen edhe në këtë rezolutë.

Shtesa 3

Programin Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve ILO / IPEC në Shqipëri

Në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta po implementohet **programi** "Mbi eliminimin e punës së fëmijëve në Shqipëri", si bashkëpunim i kësaj Ministrie me Programin Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve ILO/IPEC nga viti 2001, për t'iu përgjigjur realitetit të ekzistencës dhe përhapjes së dukurisë së punës të fëmijëve në Shqipëri. Ky Program synon vendosjen e një kuadri institucional, forcimin e kapaciteteve kombëtare, si dhe hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive që do të ndihmojnë në eliminimin progresiv të punës së fëmijëve dhe veçanërisht të formave më të këqia të saj.

Për këtë:

- Është krijuar **Komiteti Drejtues Kombëtar** për programin "Mbi eliminimin e punës së fëmijëve në Shqipëri", që në nëntor 2001, në nivel ndërdikasterial i kryesuar nga ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale, dhe me pjesëmarrje nga Presidenca, ministritë e linjës, organizatat e punëmarrësve dhe të punëdhënësve, si dhe nga shoqëria civile, si organi më i lartë vendimmarrës dhe mbështetje për integrimin e çështjes së punës së fëmijëve në politikat kombëtare dhe strategjitë që hartohen;
- Krijimi dhe funksionimi i **Njësisë së punës të fëmijëve,** si strukturë e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta që funksionon në nivel administrativ si pikë fokale kombëtare dhe bashkërenduese e veprimtarive që lidhen me punën e fëmijëve në nivel kombëtar, duke ndihmuar në transmetimin çështjeve të punës së fëmijëve në procesin e politikëbërjes.

Njësia e punës së fëmijëve është përqendruar në:

- Forcimin e kapaciteteve institucionale dhe rritjen e kapacitetit të inspektorëve të punës dhe partnerëve që lidhen me këtë çështje nëpërmjet trajnimit të tyre për dukurinë e punës së fëmijëve, identifikimin, monitorimin dhe trajtimin efektiv të punës së fëmijëve me theks të veçantë në format më të këqjia të punës së fëmijëve, ku kanë marrë pjesë përfaqësues të arsimit, të rendit, të shëndetësisë, të pushtetit lokal, si dhe OJF që veprojnë në këtë fushë;
- Bashkëpunimin me Inspektoriatin e Punës për vendosjen e inspektimit të punës së fëmijëve si pjesë e rëndësishme e planeve të inspektimit;
- Studimin për rishikimin e legjislacionit kombëtar lidhur me punën e fëmijëve për harmonizimin e tij me standardet ndërkombëtare, duke dhënë rekomandime të rëndësishme si për përmirësimin e legjislacionit kombëtar, ashtu edhe për zbatimin e atij ekzistues;

- Politikat kombëtare për luftën kundër punës së fëmijëve dhe eliminimin e formave të saj më të këqjia, që do të konkretizohen me finalizimin e raportit kombëtar për këtë çështje dhe rekomandime për politikat kombëtare që duhen hartuar nga qeveria shqiptare, që do të kontribojnë në eleminimin progresiv të punës së fëmijëve.
- Rritjen e ndërgjegjësimit të përgjithshëm lidhur me dukurinë e punës së fëmijëve dhe pasojat e saj, fushata ndëgjegjësuese, si dhe botime e veprimtari mediatike për këtë qëllim;
- Implementimin e projektit për sistemin e monitorimit të punës së fëmijëve, i cili po pilotohet në qytetet Tiranë, Korçë e Berat dhe që synon institucionalizimin e monitorimit të punës së fëmijëve, ndërmarrjen e aksioneve dhe të veprimeve që do të kontribonin në tërheqjen nga puna dhe parandalimin e dukurisët në këto tri rajone, nëpërmjet adresimit dhe referimit të drejtë të këtij problemi; forcimit të kapaciteteve në nivel qendror dhe lokal; pilotimit në bazë komuniteti në këto;

Ky projekt nëpërmjet një strategjie të caktuar do të kontribojë që partnerët, të cilët lidhen me punën e fëmijëve në nivel lokal të kenë mundësi të punojnë efektivisht së bashku:

- Për të identifikuar dhe për të ndihmuar fëmijët në situata të rrezikshme pune nëpërmjet referimit të rasteve të shërbimeve që ofrohen në nivel lokal;
- Për shkëmbimin e informacionit për këtë problem ndërmjet partnerësh që punojnë në këtë fushë;
- Për parandalimin e dukurisë dhe rehabilitimin e fëmijëve që punojnë dhe viktima të trafikut.